



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

VENDIM

Nr. 113, dt. 25.05.2016

Në mbështetje të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar, Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 25.05.2016, pasi shqyrtoi paketën e ndërhyrjeve mirëmbajtëse të DRKK-Vlorë për vitin 2016 e diskutuar më parë dhe në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

VENDOSI:

1. Miratohet “Paketa e ndërhyrjeve mirëmbajtëse të DRKK-Vlorë të objekteve:
 - Ura e Slapit;
 - Rruga Justin Godard;
 - Porta në kullën e Dervish Aliut;
 - Ura e Bratajt;
 - Porta hyrëse në kalanë e Onhezmit;
 - Kisha e Shën Janit;
 - Çatia e Xhamisë në Kalanë e Borshit;
 - Muri rrethues në Manastirin e Zvërnecit;
 - Banesa e “Klubit patriotik Labëria” (muzeu etnografik, Vlorë).
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO KURSHI



SEKRETAR I KKR
ARTA DOLLANI